Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 16, nenin 1.3 nën paragrafin (c) dhe (d) te Rregullores e UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, shtojcës VI paragrafin (i) te Rregullores se UNMIK-ut 2002/5 të datës 04 Mars 2002, mbi ndryshimin e Rregullores e UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, nenin 79 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 2004 / 04, Planin strategjik për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë 2008 – 2013, Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 03/207 të datës 19.07.2006, për miratimin e Planit të Veprimit për ndarjen e përgjegjësive në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Shëndetësisë përkitazi me Entin Special në Shtime, Me qëllim të sigurimit të koordinimit dhe vazhdimësisë së shërbimeve cilësore për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të shëndetit mendor në të gjitha nivelet e organizimit të kujdesit shëndetësor:

Nxjerr:

Udhëzim Administrativ(në Shëndetësi) Nr. 07/ 2009

Për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të rregullojë organizimin, administrimin, veprimtarin dhe monitorimin e shërbimeve profesionale të shëndetit mendor në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Shërbimi profesional i shëndetit mendor (në tekstin e mëtejmë, Shërbimi) organizohet në tri (3) nivele të kujdesit shëndetësor dhe shtatë (7) njësi funksionale administrative-regjionale.

Neni 3

1. Shërbimi, mbështetet në resurset e bashkësisë dhe përqendrohet në fuqizimin e familjeve të personave me sëmundje dhe çrregullime te shëndetit mendor.

2. Shërbimi, respekton dinjitetin, autonominë dhe integritetin e të sëmurëve, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Shërbimi, këshillohet nga Këshilli Profesional i Shëndetit Mendor sipas Udhëzimit Administrativ 27/2007 .

4. Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë dhe tërësisë së kujdesit shëndetësor, Shërbimi koordinon aktivitetet me shërbimin e mjekësisë familjare, shërbimet spitalore dhe klinike, shërbimet e mirëqenies sociale, shërbimet e punëve të brendshme, shërbimet e drejtësisë, institucionet private të kujdesit shëndetësor që janë të licencuara dhe organizatat joqeveritare.

5. Resurset njerëzore në Shërbim zhvillohen në bazë të Planit Strategjik të Shëndetit Mendor të Kosovës 2008 – 2013.

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Universitetet e licencuara vendore dhe ndërkombëtare mund të nënshkruajnë Marrëveshje të Bashkëpunimit, me qëllim të përkrahjes, mbështetjes së shërbimeve të shëndetit mendor dhe zhvillimit akademik të studentëve të tyre.

Neni 4

Niveli parësor

Shërbimet e shëndetit mendor në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor ofrohen nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare.

Neni 5

Niveli dytësor

Shërbimet e shëndetit mendor në nivelin dytësor të kujdesit shëndetësor ofrohen nëpërmjet rrjetës së shtatë (7) shërbimeve profesionale të shëndetit mendor, të ndara në bazë regjionale, reparteve psikiatrike në spitale dhe Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve psikiatrik në Shtime.

Neni 6

Niveli tretësor

Shërbimet e shëndetit mendor në nivelin tretësor të kujdesit shëndetësor ofrohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Klinikën e Psikiatrisë dhe Qendrën për Shëndet Mendor për Fëmijë dhe Adoleshent.

Neni 7

Njësitë administrative dhe organizative – funksionale të Shërbimit

1. Çdonjëra prej shtatë (7) njësive administrative- regjionale të Shërbimit nga neni 2 përbëhet nga institucionet dhe njësit organizative – funksionale si vijon :

1.1 Qendra e shëndetit mendor;
1.2 Shtëpia për integrim në bashkësi;
1.3 Njësia e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë.

2. Njësitë administrative të Shërbimit zbatojnë programe unike të trajtimit, të bazuara në të dhëna shkencore, të propozuara nga asociacionet profesionale të vendit, pas miratimit nga Ministria e Shëndetësisë.
3. Personeli për njësit administrative të Shërbimit është përcaktuar në Shtojcën 1 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 8

Qendra e Shëndetit Mendor

1. Qendra e shëndetit mendor (QSHM) ofron shërbimet terapeutike, si vijon:

1.1 Psikoedukim në grupe shumëfamiljare;
1.2 Vizita shtëpiake të ekipeve mobile, multidisciplinare;
1.3 Vizita në repartet e psikiatrisë;
1.4 Vizita në burgje;
1.5 Teknika të ngritjes së vetëdijes për fuqitë personale;
1.6 Konsultime me shërbimet e mjekësisë familjare;
1.7 Konsultime telefonike ;
1.8 Psikoterapi individuale, familjare dhe grupore;
1.9 Ndërtim të rrjetit social jashtë familjes;
1.10 Aktivitete rehabilituese dhe të punës;
1.11 Aktivitete të edukimit shëndetësor;
1.12 Zbatim të terapisë antipsikotike.

Neni 9

Shtëpia për integrim në bashkësi

1. Shtëpia për integrim në bashkësi ofron kujdes kohë-gjatë shëndetësor në funksion të rehabilitimit dhe re-integrimit social të klientëve me sëmundje dhe çrregullime kronike te shëndetit mendor.

2. Me qëllim të vlerësimit dhe pranimit të klientëve me probleme kronike të shëndetit mendor në Shtëpitë për Integrim në Bashkësi (në tekstin e mëtejmë, Shtëpia) dhe Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve psikiatrik në Shtime, Ministria e Shëndetësisë, formon Komisionin përkatës profesional (në tekstin e mëtejmë, Komisioni).

3. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë; 4 (katër) anëtarë të përhershëm dhe 1(një) anëtarë sipas funksionit. Anëtarë i komisionit sipas funksionit është Drejtori i njësisë administrative të Shërbimit ku bëhet pranimi i klientit. Anëtarë të përhershëm të Komisionit janë: Drejtori i Departamentit të shërbimeve shëndetësore në Ministri të Shëndetësisë, Shefi për Shëndet Mendor në Ministri të Shëndetësisë, Psikiatër i deleguar nga Asociacioni i Psikiatërve të Kosovës dhe punëtori social i deleguar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

3. Mandati i anëtarëve të Komisionit është një vit.

4. Procedura për pranim fillon me vlerësim individual të çdo klienti të udhëzuar për trajtim, rehabilitim dhe re-integrim social, nga njësia administrative e Shërbimit.

5. Procedurës së pranimit mund t'i nënshtrohen vetëm klientët e moshës 18 deri në 65 vjet, sipas parimit të regjionalizimit.

6. Kusht për pranim në Shtëpi është pëlqimi i klientit.

7. Në Shtëpi, pranohen vetëm klientët me sëmundje dhe çrregullime kronike psikotike në remision.

8. Në Shtëpi, nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, demencat e të gjitha llojeve, sëmundjet e vartësisë, dhe rastet sociale.

9. Për pranim klienti/ja duhet të ketë dokumentet, si vijon: certifikatën familjare, certifikatën e gjendjes materiale si (fletë posedimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme), dokumentacioni i kompletuar i trajtimeve të mëparshme.

10. Qëndrimi në Shtëpi është me afat të caktuar kohor. Rishqyrtimi i rasteve individuale bëhet çdo tre muaj apo më herët varësisht nga gjendja e klientit.

11. Shtëpia, familja dhe klienti ose përfaqësuesi i tij/saj ligjor lidhin kontratë bashkëpunimi në përmbushjen e obligimeve të ndërsjella .

12. Komisioni dorëzon raporte te rregullta për Ministrin e Shëndetësisë, çdo tre muaj.

13. Puna e anëtarëve të Komisionit kompensohet në bazë të akteve nënligjore në fuqi.

Neni 10

Njësia e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve

Njësia e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve ofron shërbime ambulatore, jashtë-spitalore të kujdesit për fëmijët dhe adoleshentët në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, deri në ndërtimin e objekteve përkatëse të përcaktuara me Planin strategjik të shëndetit mendor 2008 – 2013. Për këtë qëllim, të gjithë të punësuarit në këto njësi duhet të kalojnë në listat e pagave të Shërbimit.

Neni 11

Repartet e psikiatrisë

Repartet e psikiatrisë ofrojnë shërbime të nivelit dytësor – spitalor dhe janë funksionalisht të ndërlidhura me Shërbimin.

Neni 12

Organizimi territorial i Shërbimit

1. Shërbimi organizohet në territoret, si vijon: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Ferizaj.
2. Njësia administrative e regjionit të Prishtinës, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Prishtinës dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në

komunat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Gllogovc , Lypjan dhe Graqanicë.

3. Njësia administrative e regjionit të Mitrovicës, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Mitrovicës dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
4. Njësia administrative e regjionit të Gjilanit, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Gjilanit, dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Gjilan, Viti, Kamenicë , Novo Bord ,Ranillugë, Kllokot dhe Partesh.
5. Njësia administrative e regjionit të Pejës quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Pejës, dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Pejë, Deçan, Klinë, Junik dhe Istog.
6. Njësia administrative e regjionit të Gjakovës, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Gjakovës, dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Gjakovë, Malishevë dhe Rahovec.
7. Njësia administrative e regjionit të Prizrenit, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Prizrenit, dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Prizren, Suharekë, dhe Dragash.
8. Njësia administrative e regjionit të Ferizajt, quhet Shërbimi profesional i shëndetit mendor të Ferizajt, dhe përfshinë njësit organizative – funksionale në komunat: Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Shtërpce.

Neni 13

Administrimi i shërbimeve të shëndetit mendor në nivelin dytësor

1. Çdo njësi administrative e Shërbimit menaxhohet nga Drejtori i shërbimit profesional të shëndetit mendor në regjion, që zgjidhet me konkurs publik.
2. Selia e Drejtorit regjional të shërbimit profesional të shëndetit mendor është në Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor.
3. Drejtorët regjional të shërbimeve profesionale të shëndetit mendor i përgjigjen Shefit të Zyrës për shëndet mendor në Ministrinë e Shëndetësisë.
4. Shefi i Zyrës për shëndet mendor në Ministri të Shëndetësisë koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave të shëndetit mendor dhe burimeve njerëzore.
5. Shërbimi profesional i shëndetit mendor regjional koordinon aktivitetet profesionale me Spitalet-Repartet psikiatrike dhe QKUK-Klinikën e Psikiatrisë.
6. Spitali i Gjakovës dhe Shërbimi profesional i shëndetit mendor i Gjakovës me Memorandum të veçantë të Mirëkuptimit zbatojnë pilot projektin e përcaktuar me Planin Strategjik të shëndetit mendor të Kosovës 2008 – 2013, duke filluar nga 01.06.2009.
7. Zbatimi i pilot projektit nga paragrafi paraprak nuk nënkupton ndryshimin e statutit të Spitalit të Gjakovës, deri në analizën e rezultateve përfundimtare.

Neni 14

Çdo njësi administrative e Shërbimit organizon mbledhjen, analizën dhe raportimin e rregullt të të dhënave statistikore, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, në pajtim me ligjin.

Neni 15

1. Çdo njësi administrative e Shërbimit vendos marrëdhënie me Drejtoritë përkatëse komunale të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale, në bazë të memorandumeve të veçanta të bashkëpunimit.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministritë përkatëse miratojnë protokollet e referimit nga shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet e mirëqenies sociale, dhe organizatat joqeveritare të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 16

Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor

1. Me qëllim të integrimit të shërbimeve të shëndetit mendor në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor si dhe me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së kujdesit terapeutik brenda regjioneve përfshirëse, shërbimi themelon Bordet Bashkëpunuese të Shëndetit Mendor (në tekstin e mëtejmë, Bordet).
2. Bordet përbëhen nga përfaqësuesit e të gjitha institucioneve që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor në territorin përkatës: Reparti i psikiatrisë (në spital ose në Klinikën e Psikiatrisë), Shërbimi përkatës profesional i shëndetit mendor, Shërbimi i mjekësisë familjare, Qendra për mirëqenie sociale, Shërbimi Policor i Kosovës, Shërbimi i burgjeve, përfaqësuesit e shoqërisë civile.
3. Bordin e kryeson Drejtori i Shërbimit profesional të shëndetit mendor në territorin përkatës dhe Udhëheqësi i repartit të psikiatrisë, në mënyrë alternative, çdo vit.
4. Bordi mbanë mbledhje një herë në muaj.

Neni 17

Këshilli mbikëqyrës i të drejtave të njeriut të sëmurëve psikiatrik

1. Ministria e Shëndetësisë organizon monitorimin e respektimit të dinjitetit, të autonomisë dhe mëvetësisë së të sëmurëve psikiatrik.

2. Ministri i Shëndetësisë, në propozim të Sekretarit të Përhershëm, emëron anëtarët e Këshillit mbikëqyrës të të drejtave të sëmurëve psikiatrik.

3. Këshilli Mbikëqyrës i të Drejtave të Sëmurëve Psikiatrik (në tekstin e mëtejmë, Këshilli) është organ i pavarur që emërohet me qëllim të sigurimit të respektimit të drejtave të sëmurëve psikiatrik, klientëve të institucioneve të shëndetit mendor të Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet e kujdesit për shëndetin mendor pavarësisht nga forma e pronësisë.

4. Këshilli emërohet për territoret e shërbimeve profesionale nga neni 12 i këtij udhëzimi administrativ.

5. Këshilli ka pesë (5) anëtarë. Anëtarët zgjedhën prej organizatave joqeveritare (OJQ) Kosovare, prej organizatave të tjera lokale si dhe nga radhët e personaliteteve të Republikës së Kosovës.

6. Mandati i anëtarëve të Këshillit është dy vite.

7. Ministria e Shëndetësisë nuk është pjesëmarrëse e Këshillit.

8. Këshilli ka për detyrë të dëgjoj mendimet e të sëmurëve psikiatrik për kualitetin e kujdesit shëndetësor, të shqyrtoj deklaratat në lidhje me abuzimet, mospërfilljet apo vdekjet jo natyrore të të sëmurëve psikiatrik;

9. Këshilli bënë vizita të lajmëruara ose të paparalajmëruara në institucionet e shëndetit mendor të Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga forma e pronësisë.

10. Institucionet relevante shëndetësore janë të obliguara që të ofrojnë bashkëpunim të plotë me rastin e zbatimit të këtyre vizitave.

11..Këshilli shqyrton raportet e përgatitura nga OJQ-të apo agjensionet e tjera përkitazi me punën e këtyre institucioneve; raporton dhe bënë rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë me qëllim të përmirësimit të kualitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë së shërbimeve.

12. Këshilli duhet të vizitojë institucionet përkatëse shëndetësore çdo tre (3) muaj. Drejtori i institucionit e informon Këshillin për zhvillimet e fundit brenda institucionit ndërsa anëtarët e Këshillit e informojnë me shkrim Drejtorin për konkluzionet pas kryerjes së vizitës.

13. Këshilli dorëzon raportin tre (3) mujorë, (6) gjashtë mujorë dhe vjetor për Ministrin e Shëndetësisë, Sekretarin e Përhershëm dhe Shefin e Shëndetit Mendor.

14. Puna e anëtarëve të Këshillit kompensohet në bazë të akteve nënligjore ne fuqi.

Neni 18

Financimi

1. Shërbimet profesionale te shëndetit mendor në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor financohen nga buxheti komunal për shëndetësi.
2. Shërbimet profesionale te shëndetit mendor në nivelin dytësor të kujdesit shëndetësor financohen nga vija e ndarë buxhetore e Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Repartet e psikiatrisë në spitale dhe në Klinikën e psikiatrisë të QKUK-së financohen nga buxhetet e institucioneve përkatëse.
4. Me qëllim të sigurimit të ardhjes së rregullt në seancat e psikoedukimit në grupe shumë familjare ndahet buxheti për shpenzimet e transportit të anëtarëve të familjeve deri te qendrat e shëndetit mendor në vlerë të transportit publik për dy (2) anëtarë të çdo familje.

Neni 19

1. Institucionet e shëndetit mendor, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, mund të krijojnë të hyra vetanake dhe duhet te trajtohen sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit si dhe akteve tjera ligjore ne fuqi.
2. Përkitazi me të hyrat plotësuese të Shërbimit, që dalin nga të drejtat pronësore të shfrytëzuesve të të sëmurëve psikiatrik në shtëpitë për integrim në bashkësi dhe në Qendrën për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve psikiatrik në Shtime, përgatitet plan i veçantë financiar.

Neni 20

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime

1. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (në tekstin e mëtejmë, Qendra), ofron trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve kronik psikiatrik nga të gjitha njësitë administrative të Shërbimit, dhe është në funksion të de-institucionalizimit të banorëve të ish Institutit special në Shtime.
2. Qendra është njësi administrative e Shërbimit, që ofron kujdes të nivelit dytësor shëndetësor, si institucion i specializuar për integrimin social dhe rehabilitimin vokacional të të sëmurëve kronik psikiatrik, nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës.
3. Të sëmurët në Qendër vendosen në pajtim me nenin 9, paragrafin 2 të këtij udhëzimi administrativ dhe trajtohen në bazë të dispozitave ligjore që vlejnë për të sëmurët e tjerë, pa përjashtime.
4. Qendra është njësi e veçantë administrative e Shërbimit e cila ofron shërbime shëndetësore gjatë 24 orëve, në pajtim me planin e veçantë operativ, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë,
5. Qendra përbëhet nga: reparti psikiatrik me tridhjetë (30) shtretër dhe reparti rehabilitues – vokacional me njëzet (20) shtretër.
6. Reparti rehabilitues-vokacional nga paragrafi paraprak themelohet në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2009, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve gjeneruese në Qendër si dhe ndërtimit të bashkëpunimit me strukturat në komunitet.
7. Deri në fund të vitit 2009, numri i të sëmurëve në Qendër do të zvogëlohet në pesëdhjetë (50).

Neni 21

1. Në Qendër zbatohet politika e mospranimit, me qëllim të zvogëlimit gradual të numrit të të sëmurëve, krahas ngritjes së kapaciteteve re-integruese dhe re-socializuese në komunitet.

2. Pas arritjes së kuotës nga neni 20 paragrafi 7, pranimi dhe lëshimi nga Qendra do të bëhet vetëm në bazë të vendimit të Komisionit nga neni 9, paragrafi 2 i këtij udhëzimi administrativ, të emëruar nga Ministria e Shëndetësisë.
3. De-institucionalizimi i klientëve të Qendrës do të bëhet sipas dinamikës së caktuar kohore në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e mirëqenies sociale dhe shërbimet e tjera publike.
4. Me qëllim të rehabilitimit dhe resocializimit sa më adekuat duhet të shqyrtohet mundësia e transferimit të klientëve jokosovar të Qendrës në institucionet përkatëse jashtë vendit, më afër familjeve dhe komuniteteve të tyre, si dhe të pacientëve kosovar, nga institucionet psikiatrike jashtë vendit, në Kosovë.
5. Zyra për shëndet mendor në Ministrinë e Shëndetësisë inicon dhe përcjellë zbatimin e procedurave ligjore për shfrytëzimin e pasurive të klientëve të Qendrës dhe të Shtëpive për integrim në bashkësi, në funksion të rehabilitimit të tyre sa më të suksesshëm psikosocial.

Neni 22

Funksionalizimi i të drejtave sociale të sëmurëve psikiatrik

1. Çdonjëra prej shtatë (7) njësive administrative, territoriale të Shërbimit, zhvillon aktivitete gjeneruese të të mirave materiale nëpërmjet kooperativave sociale dhe punëtorive, me qëllim të shtimit të mundësive të punësimit në komunitet.
2. Shefi i Zyres së shëndetit mendor ne Ministri të Shëndetësisë inicon aktivitete për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Odën Ekonomike të Kosovës, asociacionet profesionale të biznesit dhe ndërmarrjet ekonomike, me qëllim të zbatimit të programeve të trajnimit vokacional dhe të punësimit të personave me sëmundje kronike psikiatrike.
3. Çdonjëra prej shtatë (7) njësive administrative, territoriale të Shërbimit, inicon aktivitete për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shërbimet e mirëqenies sociale me qëllim të sigurimit të realizimit të të drejtave të të sëmurëve psikiatrik nga mbrojtja sociale.
4. Çdonjëra prej shtatë (7) njësive administrative, territoriale të Shërbimit, inicon aktivitete për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat relevante joqeveritare me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve në procesin e kujdesit shëndetësor për të sëmurët psikiatrik si dhe fuqizimit të aktiviteteve të sektorit joqeveritar në këtë drejtim.
5. Marrëveshjet e bashkëpunimit për zhvillimin e aktiviteteve ne shërbimin e shëndetit mendor nënshkruhen nga Ministri i Shëndetësisë dhe institucionet përkatëse.

Neni 23

Hospitalizimi dhe trajtimi i detyrueshëm

Hospitalizimi dhe trajtimi i detyrueshëm i të sëmurëve psikiatrik bëhet në bazë të akteve ligjore në fuqi: Ligji për procedurën jokontestimore (Nr. 011-27/86, Neni 38, Neni 39, dhe Nenet 45 – 55; 22.Tetor, 1986), Qarkorja administrative 2001/20 mbi zbatimin e Ligjit për procedurë jokontestimore (Hospitalizimi i dhunshëm i personit në institucion neuropsikiatrik), Ministria e Drejtësisë dhe Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor Nr.2004/38.

Neni 24

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ ç'fuqizohet udhëzimi administrativ (në shëndetësi) Nr. 01/2005.

Neni 25

1. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ është Shtojca 1.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë,
21.04.2009.

Alush A. Gashi

Minister i Shëndetësisë

SHTOJCA 1

Personeli i Qendrës së Shëndetit Mendor

Kategoria e personelit	Numri/raporti në popullatë	
	I tanishëm	Synimi pas tri vjetësh
Psikiatër [1]	1 në 50.000	1 në 30.000
Infermier [2]	1 në 15.000	1 në 8.000
Psikolog	2	4
Punëtor social	1	2
Këshilltarë psikosocial	2	4
Administrator	1	1
Pastrues	2	2
Roje	3	3
Shofer	1	1

[1] Përfshin Drejtorin e Shërbimit profesional
[2] Përfshin infermierin(en) kryesor(e)

Personeli i Shtëpisë për Integrim në Bashkësi

Kategoria e personelit	Numri apo raporti në popullatë	
	I tanishëm	Synimi pas tri vjetësh
Infermierë [1]	1 në 10.000	1 në 5.000

[1] Përfshinë infermierin kryesor (e)

Personeli i Njësisë së Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoleshentëve

Kategoria e personelit	Numri/raporti në popullatë	
	I tanishëm	Synimi pas tri vjetësh
Psikiatër	1 në 300.000	1 në 100.000
Psikolog	2 në 300.000	4 në 100.000
Infermier	2 në 300.000	4 në 100.000